

Për të mbyllur kontraton e martesës, i zorë shtëpis të dhëndërit i jep të zotit e shtëpis të nuses një "facoletë", 300 grosh, edhe një "mythyr". Të gjitha këto sënde quhen "shëja" edhe të pranuarit e tyre ka vlef të madhe. Të kihyerit e tyre ose mos zbatimi i marëveshjes është një insullt e madhe edhe shumë herë rezultoi në vrasje.

Në qoftë se vajza nuk do të martohet me këtë burrë, babaj ia kthen "shëjën" dhëndërit, mirëpo vajza, gjer sa ky të jetë gjallë, nuk duhet të martohet me nonjeri tjetër. Kundravajja konsiderohet si çnderim edhe ana e djalit munt të lajë këtë turp dyke vrarë nonjë nga familja e nuses.

Pagesa e qeseve bëhet me këste edhe kusuri jepet në kohën e dasmës. Munt, fjala vjen, babaj i nuses t' i kërkojë krushkut të parë 100 grosh, të cilat t' ja shpjerë aksecilë ditë. Në qoftë se s' ja shpie atë ditë, munt që ky mik t' a giobojë, d. m. th. t' ja marë një tjetër ditë dyke i kërkuar edhe një shiojcë si dënim.

Dasma në Mirditë fillon të Shtunë edhe miqtë me fisin vinë q' atë ditë. Bijat vinë një javë përpara dasmës dhe rinë dy javë.

Kur vinë miqtë me burra, shkrehen pushkë ke dera. Nga ana tjetër grat' e fisit këndojnë: